



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Rregullores MF – NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 duke u bazuar në kërkesën e Zyrtarit për Pasuri me nr.15.11.2021 të datës 15.11.2021 Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR DEPON E SHKARKIMIT**

- I.Me këtë Vendim CAKTOHET që lokacioni i Deposë së shkarkimit për inventarin dhe pajisjet e dëmtuara dhe jashtë përdorimit të pozicionohet në kuadër të objektit të ri Komunës ku aktualisht janë të vendosura pesë drejtorate komunale, në rrugën Isa Olluri në Lipjan në pjesën e poshtme të bodrumit .
- II.Inventari dhe pajisjet e dëmtuara dhe jashtë përdorimit do të vendosen përkohësisht në depon e shkarkimit të cekur në pikën I të këtij Vendimi deri sa të bëhet vlerësimi nga ana e Komisionit për ankand publik.
- III. Përgjegjës për depon e shkarkimit do të jetë Zyrtari/ja për shkarkimin e pasurisë jofinanciare .
- IV.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Administratë.
- V.Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Administratë, Zyrtari për pasuri dhe Zyrtari/ja për pranimin e pasurisë jofinanciare.

1Nr.353-71652
Lipjan, më 17.11.2021

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

